

URDHËR
Nr. 291, datë 30.12.2022

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË
KONTABILITETIT NR. 15, “PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN
FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE EKONOMIKE” (SKK 15)**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike (SKK 15)”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

STANDARDI 15
PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE
EKONOMIKE
I PËRMIRËSUAR
(I ndryshuar)

Tiranë, ~~Janar 2022~~ dhjetor 2022

KËRKESAT BAZË TË DETYRUESHME PËR MIKRONJËSITË

13. Pasqyrat financiare të shkurtuara përgatiten paraqiten dhe publikohen të paktën një herë në vit.

DATA DHE RREGULLAT E HYRJES NË ZBATIM TË KËTIJ STANDARDI

60. Ky standard me ndryshimet përkatëse do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël, që fillon më ose pas datës 1 janar 2022. Ndryshimet e publikuara në prill 2022 ~~duhet do të zbatohet~~ zbatohen në mënyrë prospektive nga data 1 janar ~~2022~~2028, d.m.th pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit ~~2021~~2027, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit. Ndryshimet e publikuara në dhjetor 2022 do të zbatohen nga data 1 janar 2028. Lejohet zbatimi i mëhershëm i ndryshimeve të publikuara në prill 2022 dhe dhjetor 2022 duke e shpjeguar arsyen në shënimet shpjeguese.